



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 164, datë 25.05.2021

PËR NDËRPRERJEN DHE PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT TË PASURISË DHE FIGURËS PËR PROKURORIN SALI HASA, KANDIDAT PËR POZICIONIN E DREJTUESIT NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË SARANDË

Bazuar në nenin 149/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 159, pika 1 dhe 2 germa "a", 184 dhe 189, pika 1, të Ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, në nenin 52, të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në pikën 6, Seksioni B, të Kreut V, të Rregullores "Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve", miratuar me Vendimin nr. 171, datë 27.9.2019 e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, i ndryshuar, si dhe pasi u njoh me Relacionin "Për ndërprerjen dhe përfundimin e procedurës së verifikimit të pasurisë, figurës për prokurorin Sali Hasa, kandidat për pozicionin e drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë", Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Ndërprerjen dhe përfundimin e procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës për prokurorin Sali Hasa, kandidat për pozicionin e Drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë, sipas Relacionit bashkëlidhur.
2. Të njoftohet për këtë vendim z. Sali Hasa.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

**KRYETAR
GENT IBRAHIMI**




ANËTAR
KOSTAQ BELURI



ANËTAR
BUJAR SHESHI



ANËTAR
NURIHAN SEITI



ANËTAR
ELOIDA GOXHI



ANËTAR
ESMERALDA KESHI



ANËTAR
MOISI DUDA



ANËTAR
VATË STAKA



ANËTAR
SANDËR BECI



ANËTAR
TARTAR BAZAJ

